

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	220/70100-26-4957-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Matjet gjeodezike te ndërtesave brenda QKUK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Consult Engineering sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shaqir Kuka pn, _____
(Adresa)

Kaçanik _____
(Vendi)

71000 _____
(Kodi postar)

044431224 _____
(Numri Telefonit)

_____ (Numri i Faks-it)

Jakup Kuka _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@consult-eng.com _____
(Adresa elektronike)

07.08.2026 _____
(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datë 23.06.2026

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 07.08.2026

Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët

Kërkesa për rishqyrtim 29.07.2026

Vendim për refuzim ndaj kërkesës për rishqyrtim me datë 31.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 29.07.2026 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK ka vendosur kërkesa për pajisje gjeodezike të cilat kufizojnë konkurrencën ndërmjet OE.

Me datë 31.07.2026 AK ka publikuar vendimin përmes të cilit ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim, duke e vlerësuar si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e pretenduara sipas LPP

- ✓ Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar),
 - Neni 1
 - neni 7, paragrafi 2, 4 dhe 5;
 - Neni 28, paragrafi 2

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Hyrje:

Si OE te interesuar për këtë aktivitet te prokurimit publik kemi gjetur se AK ka vendosur kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale ne kundërshtim me vete qëllimin e kontratës (matje gjeodezike për regjistrimin e ndërtesave ne kadastër), duke kërkuar dëshmi për pajisje gjeodezike te cilat nuk janë pjese e asnjë kërkesë profesionale, ligjore apo administrative brenda natyrës se këtyre shërbimeve profesionale. Ne këtë kuptim, vlerësojmë se në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit, AK ka vendosur kërkesa me qëllim që te kufizojë konkurrencën e OE, duke e vënë këtë aktivitet në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Kjo rezulton qarte jo vetëm nga kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, por edhe nga sqarimet që AK ka publikuar në përgjigje të pyetjeve të operatorëve ekonomikë, si dhe në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Në vijim, këtë vlerësim do ta argumentojmë në mënyrë të detajuar përmes pretendimeve përkatëse ankimore.

Pretendim ankimor.

Në kuadër të kërkesave lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, kërkesa nr. 4 përcakton listën e pajisjeve, posedimin ose disponueshmërinë e të cilave operatori ekonomik duhet ta dëshmojë, si në vijim:

Kërkesa 4. Lista e Pajisjeve të operatorit ekonomik me përbërje si në vijim

- 1.PAISJE GJEODEZIKE GPS (1 copë)**
- 2.PAISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK-Advanced Engine System me 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me dual kamerë në kontrollor- terminal, me opsion rilevimi-skanimi 3D me fotografi dhe piketimi real view me kamere dhe software 3D model (1 copë)**
- 3.PAISJE GJEODEZIKE TOTAL STATION ROBOTIC+GPS+HYBRID. (1 copë)**
- 4.PAISJE GJEODEZIKE TOTAL STATION me laser minimum 1000 m', dhe saktësi këndore 1 sekond (1 copë)**
- 5.PAISJE GJEODEZIKE DRON GJEODEZIK me modul RTK antenë dhe me kamerë minimum 48 MP. (1 copë)**
- 6.PAISJE GJEODEZIKE Dron Advanced Engine me RTK të integruar dhe me dual gimbal opsione per dy kamera kompatibil me kamere standarde per aerofotogrametri dhe opsion per SLAM LIDAR 3D SCANNER SYSTEM, me 55 minuta fluturim, me sensor 6 drejtimesh, me kamere. (1 copë)**
- 7.PAISJE GJEODEZIKE Sistem LIDAR 3D për Dron, Saktësi pozicionimi 1cm horizontal dhe 2cm vertikal, fushëveprim deri 300m, dhe Memorie 1 TB. (1 copë)**
- 8.PAISJE KOMPJUTERIKE PC KOMPJUTER për procesim të dhënave GJEODEZIKE dhe për projektim me performance të larta hardverike, minimum processor CPU i9, RAMDDR5, Kartelë grafike RTX4080, SSD 1TB. (1 copë)**

Nga përmbajtja e kërkesës nr. 4 lista e pajisjeve, rezulton qartë se dosja e tenderit përmban kërkesa që tejkalojnë natyrën dhe përmbajtjen e shërbimeve që parashihen të realizohen në kuadër të kësaj kontrate. Vendosja e këtyre kërkesave nuk mbështetet në nevojat reale të kontratës dhe krijon dyshime të bazuara se ato janë përcaktuar me qëllim të kufizimi te konkurrencës, rrjedhimisht te favorizimit të operatorëve ekonomikë të caktuar.

Siç mund të konstatohet nga specifikimet teknike të dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar kërkesa të qarta teknike dhe profesionale, metodologjinë që

duhet të ndiqet, rezultatet specifike që duhet të arrihen, si dhe standardet apo referencat administrative dhe kadastrale që duhet të përmbushen gjatë realizimit të kontratës. Për rrjedhojë, në dokumentacionin e tenderit mungon çdo arsyetim konkret që do të dëshmonte domosdoshmërinë e posedimit ose të vënies në dispozicion të pajisjeve të kërkuara nga operatorët ekonomikë.

Këtë mungesë të ndërlidhjes ndërmjet pajisjeve të kërkuara dhe objektit të kontratës, AK e ka konfirmuar edhe përmes përgjigjeve të publikuara ndaj pyetjeve të operatorëve ekonomikë, si për shembull:

Pyetja: 3.1. *Pse është e domosdoshme që pajisja GPS/GNSS RTK, sipas kërkesës 4.2, të posedojë 1,408 kanale satelitore dhe të jetë e pajisur me kamerë të dyfishtë në kokën e marrësit?*

Meqenëse në Aneksin 1 nuk i keni specifikuar kërkesat konkrete për matjet gjeodezike, ju lutemi të sqaroni se cila kërkesë që lidhet me zbatimin e kësaj kontrate nuk mund të përmbushet nga një pajisje tjetër GPS/GNSS RTK me karakteristika të ndryshme.

Cila është kërkesa ligjore ose administrative e autoritetit kompetent për kadastër, sipas së cilës një pajisje tjetër GPS/GNSS RTK, me karakteristika të ndryshme, nuk mund t'i përmbushë kërkesat për realizimin e matjeve përkatëse?

Gjithashtu, pse është përcaktuar numri minimal prej 1,408 kanalesh satelitore për këtë pajisje?

Përgjigja e AK:

Përgjigje për pyetjen 3.1

Kërkesa për GPS/GNSS RTK është vendosur duke marrë parasysh se kontrata përfshin matjen e një numri të madh objektesh brenda kompleksit të QKUK-së. Pajisja kërkohet për të siguruar efikasitet, saktësi dhe realizim të punimeve brenda afatit. Specifikimet janë përcaktuar si kërkesa minimale teknike që Autoriteti Kontraktues i konsideron të nevojshme për këtë projekt.

Pra, nga përgjigja AK ka dëshmuar se:

1. Nuk ekziston asnjë kërkesë e bazuar profesionale që lidhet me zbatimin e kësaj kontrate dhe që nuk mund të përmbushet me pajisje tjetër GPS/GNSS RTK me karakteristika të ndryshme.
2. Nuk ekziston asnjë kërkesë ligjore ose administrative e autoriteteve të kadastrit e cila nga një pajisje tjetër GPS/GNSS RTK me karakteristika të ndryshme nuk mund të përmbushet.
3. Nuk ekziston asnjë arsye/bazë profesionale që pajisja GPS/GNSS RTK duhet domosdoshmërisht të ketë numri minimal prej 1,408 kanalesh satelitore.

Në mënyrë të ngjashme, Autoritet Kontraktues e ka konfirmuar këtë qëndrim edhe përmes përgjigjeve të tjera të publikuara ndaj pyetjeve të operatorëve ekonomikë, përkatësisht në përgjigjet nr. 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 (referohu dokumentit në bashkëngjitje).

Ne anën tjetër, në kërkesën për rishqyrtim të dt. 28.07.2026 kemi theksuar se: “Përmes këtyre përgjigjeve, në thelb keni konfirmuar se **kërkesa është përcaktuar mbi bazën e**

diskrecionit të Autoritetit Kontraktues, pa u mbështetur në ndonjë nevojë konkrete teknike, profesionale apo administrative”.

AK ne përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim ka konfirmuar pretendimin tonë, citat:

Për më tepër, dokumentacioni i vetë Aneksit 1 (Specifikimet Teknike të Detyrueshme) e vendos objektivin e kontratës në kontekstin e një kompleksi me 32 ndërtesa/objekte spitalore. Përdorimi i dronit dhe sistemit LiDAR mundëson përfundimin efikas, të saktë dhe me ndikim minimal operacional (fluturime më të pakta, kohë më e shkurtër ekspozimi mbi një institucion shëndetësor aktiv) të matjeve mbi një sipërfaqe kaq të gjerë, krahasuar me metoda krejtësisht klasike, siç shpjegohet në pikat 3.4–3.6 të përgjigjes së datës 21.07.2026. Metodologjia e zgjedhur (kombinim i pajisjeve klasike me dron/LiDAR) mbetet brenda diskrecionit teknik të Autoritetit Kontraktues për të përcaktuar mjetet e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar, në përputhje me nenin 9 dhe nenin 28 të LPP-së.

Rikujtojmë se nuk ekziston asnjë baze ligjore për procedura te prokurimit publik qe lejon diskrecion te AK për te vendosur kërkesa teknike dhe profesionale. Ekziston vetëm baze ligjore (neni 69.4) qe lejon vendosjen e kërkesave teknike te ndërlidhura direkt me kërkesën për ofrimin e shërbimeve. Çdo kërkesë teknike/profesionale e cila nuk është e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve te kërkuara ndikon ne kufizim te konkurrencës se OE, rrjedhimisht te favorizimit te OE te caktuar. Po ashtu ndikon ne mos shfrytëzim te drejte dhe racional te fondeve publike te Kosovës.

Qëndrimet kontradiktore të Autoritetit Kontraktues:

AK në përgjigjen e ofruar ndaj një OE tjetër, konfirmon se qëllimi i aktivitetit te prokurimit është i bazuar ne legjislacionin ne fuqi për kadastrin ne Republikën e Kosovës, citat:

Përgjigje ne kërkesë për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues QKUK e konsideron te pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim për faktin se përmbajtja e kësaj kërkesë për rishqyrtim ka forme te kërkesës për informata shtesë.

Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi kryesor i këtij aktiviteti të prokurimit është matja e objekteve brenda hapsirës së QKUK-së për qëllime te regjistrimit dhe përditësimit të tyre në Librezën Kadastrale / Fletën Poseduese, sipas legjislacionit në fuqi për kadastrin në Republikën e Kosovës.

Meqenëse AK konfirmon se shërbimet të cilat kërkohen brenda kësaj kontrate janë sipas legjislacionit në fuqi të kadastrit, atëherë kujtojmë se legjislacioni i njëjtë zgjidhë dhe dy çështje të tjera themelore për këtë aktivitet të prokurimit, të cilat AK nuk i ka përfillur, si:

- 1. Kush ka të drejtë të kryejë matjen e ndërtesave dhe të përgatisë dokumentacionin për regjistrimin e tyre në kadastër?**
- 2. Çfarë kapacitetesh teknike duhet të ketë në dispozicion subjekti që gëzon këtë të drejtë?**

Përgjigjet sipas legjislacionit te njëjtë janë:

- 1. Gjeodeti i licencuar ose kompani gjeodete e licencuar.**

2. Për tu licencuara, gjeodeti ose kompania gjeodete duhet të ketë në pronësi instrument profesional për matje, GPS apo stacion total.

Andaj, legjislacioni që rregullon fushën e kadastrit, së bashku me udhëzuesit përkatës të punës, përcakton qartë natyrën profesionale të shërbimeve që kërkohen me këtë tender, subjektet kompetente për ofrimin e tyre, si dhe kapacitetin teknik të nevojshëm, përfshirë pajisjet profesionale që duhet të jenë në dispozicion.

Nga sa u paraqit më sipër, rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues (AK), në raport me legjislacionin kadastral, të cilit edhe vetë i është referuar, ka vepruar në mënyrë selektive dhe kontradiktore, për arsyet në vijim:

- a. Nuk ka kërkuar që shërbimet të ofrohen nga gjeodetë të licencuar ose kompani gjeodete të licencuara, ndonëse kjo kërkohet nga legjislacioni përkatës;
- b. Ka vendosur kërkesa për pajisje teknike që tejkalojnë kapacitetet profesionale të nevojshme dhe të përcaktuara nga legjislacioni për realizimin e këtyre shërbimeve.

Legjislacioni kadastral specifikon se për kryerjen e matjeve gjeodezike të ndërtesave me qëllim regjistrimin e tyre në kadastrë, kërkesat profesionale dhe administrative të fushës kadastrale mund të përmbushen me pajisje standarde gjeodezike, siç është stacioni total dhe GPS/GNSS, pa specifika të veçanta të tyre.

Dokumentet ligjore dhe teknike që specifikojnë natyrën e shërbimeve profesionale për matjen dhe regjistrimin e ndërtesave në kadastrë janë si në vijim:

1. Ligji PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/ligji-nr08-l-237-per-kadaster-te-prones-se-palujtshme.pdf>
2. UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPHI NR. 07/2024 PËR PËRCAKTIMIN E PËRMBAJTJES SË TË DHËNAVE DHE MËNYRËN E KRIJIMIT TË NJËSIVE KADASTRALE <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/udhezim-administrativ-mmphi-nr-07-2024-per-percaktimin-e-permbajtjes-se-te-dhenave-dhe-menyren-e-krijimit-te-njesive-kadastrale.pdf>
3. UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR.06/2024 PËR DHËNIEN E LEJES KOMPANIVE GJEODEZIKE DHE LICENCIMIN E GJEODETËVE <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/udhezim-administrativ-mmphi-nr-06-2024-per-dhenien-e-lejes-kompanive-gjeodezike-dhe-licencimin-e-gjeodeteve.pdf>
4. Udhëzuesi për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës) <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/udhezuesi-2024-me-isbn-final.pdf>

Konkluzion i pretendimit ankimor:

Në këto rrethana, vendosja e kërkesave për pajisje gjeodezike që tejkalojnë kapacitetin teknik të nevojshëm për zbatimin e kontratës krijon bindjen e arsyeshme se qëllimi i Autoritetit Kontraktues (AK) është kufizimi i konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe, rrjedhimisht, favorizimi i OE të caktuar.

Favorizimi i operatorëve ekonomikë nuk nënkupton vetëm rastet kur specifikohet prodhuesi ose marka e një pajisjeje, siç është përpjekur të argumentojë AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim. Ai ekziston edhe kur kërkohen pajisje ose kapacitete teknike që nuk janë objektivisht të nevojshme dhe as proporcionale me natyrën e shërbimeve profesionale që janë objekt i kontratës. Kërkesa të tilla vendosin pengesa për pjesëmarrje dhe kufizojnë konkurrencën e OE në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive në procedurat e prokurimit publik.

Të gjitha kërkesat që lidhen me pajisjet gjeodezike të specifikuar në dosjen e tenderit janë të pambështetura ligjërisht dhe profesionalisht në raport me shërbimet që duhet të realizohen.

Andaj, pajisje të tilla si droni me kamerë me rezolucion minimal prej 48 MP, droni me teknologji SLAM LiDAR 3D dhe sistemi LiDAR 3D për dron nuk përbëjnë kërkesa të përcaktuara nga standardet profesionale apo procedurat administrative që zbatohen për matjet gjeodezike dhe kadastrale për regjistrimin e ndërtesave në kadastrë.

Për më tepër, posedimi i pajisjeve të tilla nuk përbën kusht për licencimin e një gjeodeti dhe as për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fushën e gjeodezisë dhe kadastrit. E njëjta vlen edhe për kompanitë gjeodezike të licencuara, të cilave nuk u kërkohet posedimi i këtyre pajisjeve si parakusht për kryerjen e veprimtarive të licencuara.

Kjo mospërputhje ndërmjet objektit të kontratës, kualifikimeve profesionale të kërkuara dhe pajisjeve të përcaktuara dëshmon se kriteret nuk janë hartuar në mënyrë proporcionale dhe ligjore, por në një formë që kufizon konkurrencën duke favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë.

Shkeljet e LPP:

Duke vendosur kërkesa për pajisje gjeodezike të panevojshme në raport me kërkesën për ofrimin e shërbimeve, AK ka vepruar në **kundërshtim me nenin 1, nenin 7, dhe nenin 28 të LPP** sepse janë kërkesa që pamundësojnë efikasitet dhe transparencë të shfrytëzimit të fondeve publike; kufizojnë konkurrencën ndërmjet OE, duke u bërë favorizuese ndaj OE përkatës, dhe në anën tjetër diskriminuese për shumë OE të tjerë:

Neni 1, paragrafi 1:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla

Neni 7, paragrafi 2:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik

Neni 7, paragrafi 4:

Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 7, paragrafi 5:

Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

Neni 28, paragrafi 2:

Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kërkesa përfundimtare:

Duke marrë parasysh shkeljet ligjore të shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë që ANKESA të aprovohet si e bazuar dhe të ndërmerren të gjitha përmirësimet e nevojshme të kërkesës numër 4 lidhur me pajisjet e nevojshme gjeodezike.

Në mënyrë të veçantë, kërkojmë që OSHP të marrë vendim ku ndalon AK të vendosë kërkesa jashtë qëllimit të kontratës, ku:

- të largohen të gjitha specifikimet teknike kufizuese lidhur me pajisjet GPS/GNSS dhe stacionin total, duke u përcaktuar vetëm kërkesa funksionale dhe proporcionale me natyrën e shërbimeve që duhet të realizohen;
- të largohen në tërësi kërkesat për dron me kamerë me rezolucion minimal prej 48 MP, dron me teknologji SLAM LiDAR 3D dhe sistem LiDAR 3D për dron,

pasi këto pajisje nuk janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me objektin, metodologjinë dhe rezultatet e kërkuara të kontratës.

Largimi dhe korrigjimi i këtyre kërkesave është i domosdoshëm për të siguruar trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, konkurrencën e drejtë dhe shmangien e kërkesave që mund të favorizojë operatorë ekonomikë të caktuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk kemi llogaritur dëmet materiale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- c) një kopje e njoftimit për vendimin e AK.*
- d) një kopje e kërkesës për rishqyrtim e datës 29.07.2026*
- e) një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se, e datës 31.07.2026*
- f) një kopje të pyetjeve të OE dhe përgjigjeve të AK*
- g) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*